



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 10867 Prot

Shijak, më 07.12 2020

VENDIM NR. 108 DATË 07.12.2020

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR, TË NDRYSHUAR, PËR
ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, ZONA 1 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SHIJAK,
BASHKIA SHIJAK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 45, datë 22.01.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Shijak , Bashkia Shijak dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, Kryetari i Bashkisë propozoi,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor, të ndryshuar, për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1 Njësia Administrative Shijak, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi.

Pdyv-ja, e ndryshuar përfshin ndërtimin e 31 pallateve 7 dhe 8 kat ku përfshihet rindërtimi i 78.680 m² ndërtim të ndara përkatësisht si më poshtë:

- 95 apartamente 1+1;
- 303 apartamente 2+1;
- 258 apartamente 3+1;
- sipërfaqe shërbimi 9975 m²;
- sipërfaqe garazh nëntokësore 3275 m²;
- sipërfaqe të gjelbërta 8520 m²;

- venparkime të hapura 146 m2;

2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Kozeta Doda



KRYETARI I KËSHILLIT

Tauland Xheraj

